

Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë,07.06.2021

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 03.06.2021 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "Shkoza 007&Çlirimi 99", për aktivitetin: "Ndertimi i shtegut për ecje dhe vrapim Nr. të Prok: 616 20 7641 521 nxjerr:

V E N D I M

1. Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik "Shkoza 007&Çlirimi 99" e datës 31.05.2021 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndertimi i shtegut për ecje dhe vrapim" me Nr. të Prok: 616 20 107 512 kundër Njoftimit për Vendimin e Autoritetit Kontraktues, të datës 01.06.2021 të publikuara në web-faqe të KRPP-së.
2. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdojë aktivitetin sipas publikimit të datës 01.06.2021
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "Shkoza 007&Çlirimi 99" me datë 03.06.2021 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndertimi i shtegut për ecje dhe vrapim" me Nr. të Prok: 616 20 7641 521.

Autoriteti Kontraktues, me datë 01.06.2021, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

-Pretendimet tuaja janë të pa bazuara pasi që duhet ta dini se konfirmimi i anetareve të komisionit të tenderit juaj është në rregull, jo vetëm që nuk është meritore por është edhe i

kunderligjshem, pasi qe ne fazen e vleresimit lejohen vetem komunikimet me shkrim e jo komunikimet e konfirmimet tjera. Per korektesi ua perkujtoj se per te verifikuar pretendimet per nje nenshkrim te pa autorizuar te menaxherit te projektit nuk eshte dashte te kerkohet kontrata origjinale, sepse ajo vetem sa e verifikon se kontrata nuk eshte nenshkruar nga personi i cekur ne te dhe se askush nuk ka pase autorizim te nenshkruaj per te njejtin. Poashtu deshmia per paisjen grejder nuk eshte ne harmoni me kerkesat e FDT-se dhe per kete eshte e pa pranueshme.


Pretendimi se eshte rekomanduar tenderuesi me çmim me te larte se çmimi i tenderit tuaj nuk paarqet asnje shkelje, pasi qe per tu rekomanduar per dhenje te kontrates duhet te plotesoni kriteret e perzgjedhjes, pra te jeni tenderues i pergjegjshem.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Vendimi i dërgohet parashtruesit të kërkesës , departamentit të prokurimit dhe njësis së kërkesës.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjetë) diteve pas pranimi te ketij vendimi.


Zyrtari përgjegjës i Prokurimit